



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:006499

Datë: 29.05.2018

Numri i dokumentit: 00049890

**P.nr.170/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, me numër PP.nr.1788/2016 të datës 06.03.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën **29.05.2018** në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit I. K. , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **I. K. ,** i biri i S, i nënës T, e gjinisë B, data e lindjes... në fsh.S. K.Gjakovë, tani me banim në Gjakovë, Rr.....në banesë kolektive kati IV, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar- atë i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:** Më datën 28.09.2016 rreth orës 11.00 në Gjakovë në rrugën “...”derisa i pandehuri po lëvizte me veturën e tij,me të arritur tek furra”...”ndaloi në vendkalim një veturë tjetër e cila po lëvizte para tij e të cilin e drejtonte i dëmtuari ..., i pandehuri orvatej të tejkalonte veturën dhe pasi arriti ta tejkaloi shkon tek vetura e të dëmtuarit fillimisht i drejtohet me fjalët:”Ti a hajgare po bon me mua ah”dhe për një moment përdor forcën ndaj tij me çka e godet me grushta në fytyrë ashtu që i dëmtuari nga goditjet e marrura detyrohet të marr ndihmën mjeksore,dhe nga leximi i raportit del ti jenë shkaktuar lëndime të lehta trupore më gjerësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.02.02.2017.

- me çka ka kryer veprë penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1nën.par.1.4 KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,49,50,51,52 ,73 dhe nenit 188 par.1nën.par.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton;

### **DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4(**katër**) **muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(**një**) **viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale penale në emër të akt ekspertimit mjeko-ligjor të paguaj shumën prej **20.00 euro**, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **30.00 euro**.

I dëmtuari – ... nga Gjakova,rr.”...”(cerpane) nr.335, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1788/2016 të datës 06.03.2017, kundër të akuzuarit Y. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoi sipas ligjit.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj në shqyrtimin fillestar të dt.10.04.2018,pasi lexoi aktakuzën bën përmisimin e kualifikimit juridik ashtu që pas paragr.1 duhet të shtohet nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe bënë përmisimin e emrit ashtu që në vend të emrit Y. duhet të jetë emri I., këtë e bënë pasi muar në shiqim lejen e njoftimit të të njëjtit me nr.ID ..., ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Në shqyrtimin fillestar të dt.10.04.2018 i akuzuari I. K. lidhur me fajësinë ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet, pasi i njëjti u njoftuar për të drejtat e tij deri në shqyrtimin e dytë gjyqësor se ka të drejtë të paraqet kërkesë për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, deklaroi se tërhiqet nga kërkesa duke propozuar që seancën e radhës të caktoi shqyrtimin kryesor gjyqësor, gjykata pasi muar edhe pëlqimin e prokurorit të çështjes seancën e radhës caktoi shqyrtimin gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor të dt.29.05.2018,i akuzuari I. K. lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pranimin e fajësi e bëri me vullnet dhe vetëdije të plotë duke ditur më par për pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit pasi që ka konstatuar se i akuzuari bënë pranimin e fajësisë i cili pranim shihet se është bërë sipas vullnetit të lirë dhe pa imponim dhe i njëjti pranim ka mbështetje nga provat dhe shkresat e lëndës, duke propozuar që të bëhet pranimi i fajësisë së të akuzuarit.

Pasi Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, si dhe ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par. 4, të KPPK-së, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu në fjalën e vetë përfundimtare deklaroi se mbetëm në tërësi pranë aktakuzës pasi që pranimin e bërë në mënyrë të vullnetshëm dhe pa presion edhe pse u njoftuar për favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat dhe shkresat tjera në lëndë, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit të shpall fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet, si dhe të obligoi në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, si rrethanë lehtësuese i propozoi gjykatës që të merr parasysh pranimin e fajësisë gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet korrekte në gjykatë e sidomos se i njëjti për herë të parë ndeshet me ligjin edhe ndonjë rrethanë rënduese nëse gjen.

I akuzuari I. K. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se: sërisht e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam realizues i pensionit të invalidit të luftës, me këto të ardhura mbajë familjen, jam mbajtës i vetëm i familjes, për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale, por premti se edhe kjo do të jetë edhe hera e fundit, propozoi gjykatës që ti ketë parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Me faktet e ofruara, me provat që bashkëngjiten në shkresat e lëndës, e sidomos me pranimin e fajësisë nga i akuzuari është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën.par.1.4të KPRK-së, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marr parasysh gjykata ka vlerësuar rrethanat personale, është baba i 4 fëmijëve, gjendjen e tij të dobët ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e thellë të tij, sjelljet korrekte të akuzuarit në gjykim, sjelljet e mëparshme të kryesit, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale, më parë nuk ka qenë i dënuar, nuk është recidivist, si rrethanë rënduese Gjykata marr parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që në këtë mosmarrëveshje të dëmtuarit- i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, peshën e veprës penale, të gjitha këto rrethanat ndikuan që Gjykata të njëjtit ti shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të akt ekspertimit mjekoligjor, dhe paushallit gjyqësor është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2, nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**P. nr.170/17 më datë 29.05.2018.**

**Sekretarja juridike,**  
**gjykuese**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.